

Informacion mbi strukturen e grupit bankar

Union Financiar Tirane sha (“UFT” ose “Kompania Meme”) eshte nje kompani me pergjegjesi te kufizuar, me NUIS J62424002G rregjistruar ne baze te vendimit No. 9406, date 6 Mars 1995.

UFT eshte nje institucion financiar qe ushtron aktivitetin ne Shqiperi dhe autoriteti mbikeqyres i kesaj veprimtarie eshte Banka e Shqiperise, dhe ushtron aktivitetin ne perputhje me te gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Keshilli Mbikeqyres i Bankes se Shqiperise. UFT eshte Perfaqesuese Kontraktuale e Western Union Financial Services INC qe nga viti 1995, e cila ushtron veprimtarine e trasfertave te parave si dhe ndermjetesimin e arketimeve dhe pagesave te ndryshme, ate te kembimit valutor, ate te agjentit apo keshillimit financiar, te konsulences ne fushen e biznesit dhe te administrimit, te emetimi te parase elektronike (e-money). Ajo administron dhe kontrollon transfertat e parave te procesuara nepermjet Western Union ne rreth 300 nen-agjenci ne Shqiperi. Selia e UFT-se eshte ne Rruga “Ismail Qemali”.

Kapitali i UFT-se eshte 250.000 USD (me kosto historike 35.5 milion LEK) .

Me vendim date 30.05.2017, ka patur rritje kapitali ne shumen 24.5 milion LEK .

Aksionaret e saj kane kete perqindje investimi ne te:

	31 dhjetor 2020	Aksione me te drejte vote	31 dhjetor 2019	Aksione me te drejte vote
Edmond Leka	35%	35	35%	35
Niko Leka	35%	35	35%	35
Gjergji Misha	10%	10	10%	10
Varuzhan Piranjani	10%	10	10%	10
Eduard Shima	10%	10	10%	10


Administratori i UTF-se eshte z. Elton Collaku. Ai gjithashtu eshte anetar i Keshillit Mbikeqyres te Unioni Financiar Prishtine dhe Union Net Kroaci (filiale te UFT-se) si dhe anetar i Komitetit te Kontrollit te Unionit Financiar Prishtine dhe anetar i Keshillit Drejtues te Auto City sha.

Keshilli Administrimit

Edmond Leka	Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anetar
Niko Leka	Anetar

UFT pergatit pasqyra financiare individuale dhe te konsoliduara te cilat certifikohen ne baze vjetore. Auditimi i pasyrave financiare individuale per vitin 2020 eshte kryer nga kompania “Lavdimir Fusha ” (Auditures ligjor) dhe raporti i tyre mbi to eshte leshuar ne dt. 25.03.2021. Auditimi i pasqyrave financiare te konsoliduara (jo te konsoliduara) ne monedhe raportimi eur kryhet nga Grant Thornton.

UFT ka ne pronesi filialet e paraqitura grafikisht me poshte:



▪ **Unioni Financiar Prishtine Shpk. (“UFP”)**

UFP është një kompani me përgjegjësi të kufizuar që operon në Kosovë. NUIS i saj është NRB80073291. Ajo është Perfaqësuese Kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Kosovë dhe ushtron aktivitetin që nga 1 janar 2004. UFP është një institucion financiar që ushtron aktivitetin e transfertave të parave dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës. Selia e UFP është në Rr. Perandori Justinian IE, Qyteza Pejton, Prishtinë, Kosovë.

Kapitali i UFP-së është 1,000,000 EUR

Aksionaret e saj kanë këto përqindje investimi në të:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Unioni Financiar Tirane	80%	80%
Genc Turku	15%	15%
Bukurosh Stafa	5%	5%

Administratori i UFP-së është zj. Eda Shaqiri . Ajo nuk ka pozicione drejtuese në subjekte të tjera.

UFP nuk kryen transaksione me kompanitë e tjera të grupit, përveç UFT-së dhe vendosjes së depozitave të saj pranë Union Bank.

UFP përgatit pasqyra financiare individuale të cilat certifikohen në baze vjetore. Auditimi i pasyrave financiare individuale për vitin 2020 është kryer nga kompania “Grant Thornton” dhe ende janë në proces auditimi .

▪ **Unija Finansiska Skopje DOO (“UFS”)**

UFS është një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Rrepublicën e Maqedonisë me vendim të Gjykatës së Shkupit Nr.5710/03, datë 16 janar 2004. NUIS i saj është NIT4030004498497 dhe është Perfaqësuese Kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Maqedoni. Ajo ushtron aktivitetin e transfertave të parave në Rrepublicën e Maqedonisë dhe autoriteti mbikëqyrës i kesaj veprimtarie është Banka Popullore e Maqedonisë.

Kapitali i UFS është 15,323,000 MKD (ose 250,000 EUR kosto historike).

Aksionaret e saj kanë këto përqindje investimi në të:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Unioni Financiar Tirane	75.04%	75.04%
Merita Marku	3.65%	3.65%
Leka Marku	3.65%	3.65%
Nesa Marku	3.65%	3.6%
Illir Mehmeti	10%	10%
Ylli Marku	4%	4%

Drejtori Ekzekutiv UFS-se eshte z. Ylli Marku. Ai eshte gjithashtu dhe anetar i Keshillit Drejtues te Union Net Kroacia.

UFS nuk kryen transaksione me kompanite e tjera te grupit .

UFS pergatit pasqyra financiare individuale te cilat certifikohen ne baze vjetore. Auditimi i pasyrave financiare individuale per vitin 2020 eshte ende ne proces dhe eshte kryer nga kompania “Grant Thornton”.

▪ **Union of Financial Corners (“UFC”)**

UFC eshte nje institucion financiar i themeluar ne 1 maj 2005 ne Gjeneve, Zvicer dhe ka NUIS CHE 112 349 585. UFC eshte perfaqesuese kontraktuale e Western Union Financial Services INC ne Zvicer dhe ofron sherbimin e transfertave te parase. Autoriteti mbikeqyres eshte ARIF.

Kapitali i UFC eshte eshte 300 mije CHF

Aksionaret e saj kane kete perqindje investimi ne te:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Unioni Financiar Tirane	50.1%	80%
Andi Gjonej	29.99%	20%
Kristian Leka	20%	

Drejtori Ekzekutiv i UFC-se eshte z. Andi Gjonej. Ai nuk ka pozicione drejtuese ne subjekte te tjera.

UFC nuk kryen transaksione me kompanite e tjera te grupit, pervec vendosjes se depozitave te saj prane Union Bank.

UFC pergatit pasqyra financiare individuale te cilat certifikohen ne baze vjetore. Auditimi i pasqyrave financiare individuale per vitin 2019 eshte kryer nga kompania “Berney& Associates Sa” dhe raporti i tyre mbi to eshte leshuar ne dt. 03.03.2021

▪ **Paylink Sha. (“Paylink”)**

Paylink eshte nje kompani financiare e licensuar nga Banka e Shqiperise per te kryer sherbimet e procesimit te kartave si dhe sherbimeve te tjera lidhur me to. NUIS i saj eshte L22112003M dhe ka filluar aktivitetin e saj ne shtator 2012.

Objekti i Shoqerise do te perfshije, veprimtarite e meposhtme: sherbimet e pagesave dhe te transferimit te parave; emetimin dhe administrimin e te gjitha instrumenteve te pageses perfshire emetimin e parase elektronike; skeme kombetare te pagesave me karte sherbimet e “Auditimit & PenTest”, te cilat konsistojne ne sherbime te testimi te sigurise fizike dhe llogjike, si dhe simulime te penetrimit te sistemeve te teknologjise se brendshme apo te jashtme dhe çfaredolloj sherbimi tjeter ne funksion te ketyre sherbimeve ose te ngjashem me keto sherbime, duke perfshire edhe konsulencen ne lidhje me to; si dhe sherbimet keshilluese, ndermjetese dhe sherbimet e tjera ndihmese per veprimtarite sa me lart.

Kapitali i Paylink eshte 573,520.000 LEK .

Ne vitin 2020 nuk ka patur ndryshime ne strukturen e aksionareve te saj:

Unioni Financiar Tirane

31 dhjetor 2020 **31 dhjetor 2019**

100%

100%

UFT rriti kapitalin e saj ne Paylink nepermjet konvertimit ne kapital te borxhit te varur ne shumen prej 445 mije EUR (2019 : 699 mije EUR)

Administratori i Paylink eshte znj. Eneida Thomaj. Ajo mban pozicionin e kryetares se Komitetit te Kontrollit te UFP.

Keshilli Administrimit

Varuzhan Piranjani	Kryetar
Niko Leka	Anetar
Edmond Leka	Anetar
Irena Rushaj	Anetar
Eneida Thomaj	Anetar
Dritan Mollanji	Anetar

Paylink ofron sherbimin e procesimit te transaksioneve te kartave, personalizimin e kartave, monitorimi i ATM-ve, sherbime te testimit te sigurise fizike dhe llogjike per Banken Union dhe sherbime te IT audit per kompanite e tjera te grupit.

Paylink pergatit pasqyra financiare individuale te cilat certifikohen ne baze vjetore. Auditimi i pasqyrave financiare individuale per vitin 2020 eshte kryer nga kompania "Grant Thornton" dhe raporti i tyre mbi to eshte leshuar date 30.mars.2021 .

▪ **Auto City Sha ("Auto city")**

Investimi ne Auto City eshte bere ne 26 dhjetor 2012. Auto City eshte nje kompani me NUIS K81918006B dhe ka objekti i aktivitetit: Eksportim, importim, ekspozim , promovimin dhe tregetin e artikujve dhe mallrave te cdo lloji ne menyre te vecante te automjeteve, kryerjen e sherbimeve te cdo lloji vecanerisht te atyre qe lidhen me promovimin e artikujve e mallrave te cdo lloji vecanerisht te automjeteve perfshire ketu organizimin dhe menaxhimin e panajreve ekspozitave apo aktivitete te tjera te ngjashme promovuese, publikimin dhe reklamimin me qellim promovimin e mallrave, apo sherbimeve te lidhura me aktivitetin etj. UFT zoteron 100% te aksioneve ne kapitalin e Auto City. Drejtor Ekzekutiv eshte z. Ardi Afezulli dhe ai nuk ka pozicione drejtuese ne subjekte te tjera.

Keshilli Mbikeqyres

Arjan Lesha	Anetar
Elton Collaku	Anetar
Varuzhan Piranjani	Anetar

Auto City ofron sherbimin per utilitete si dhe ekspozim , ambjente me qera etj .

Auto City pergatit pasqyra financiare individuale te cilat certifikohen ne baze vjetore. Auditimi i pasqyrave financiare individuale per vitin 2020 eshte kryer nga kompania "Lavdimir Fusha" (Auditues Ligjor) dhe raporti i tyre mbi to eshte ende ne proces

Ne vitin 2020 ,UFT rriti kapitalin e saj ne Auto City nepermjet konvertimit ne kapital te borxhit te varur ne shumen prej 800 mije EUR (2018: 4.7 milion EUR)

- **Union Net Kroaci ("UUK")**

UUK është një institucion financiar i themeluar në 10 mars 2016 në Zagreb, Kroaci dhe ka NUIS HR74536886827. UUK është përfaqesues kontraktuale e Western Union Financial Services INC në Kroaci dhe ofron shërbimin e transfertave të parase.

UFT zoteron 100% të kapitalit të UUK dhe ky kapital është 1,700 mijë KUNA (221,680 EUR kosto historike)

Drejtori Ekzekutiv i UUK-se është z. Krunoslav Valentinc. Ai nuk ka pozicione drejtuese në subjekte të tjera.

UUK nuk kryen transaksione me kompanitë e tjera të grupit.

UUK përgatit pasqyra financiare individuale me bazë vjetore të cilat dorëzohen pranë autoriteteve përkatëse.

Në vitin 2020, UFT rriti kapitalin e saj në UUK nëpërmjet konvertimit të kapitalit të borxhit të varur në shumën prej 55 mijë EUR (2018 :120 mijë EUR)

- **Union Bank Sh.a,**

Union Bank Sh.a. ("Banka") është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 janar 2006 bazuar në Vendimin nr. 101, datë 28 dhjetor 2005 të Bordit Mbikëqyres së Bankës së Shqipërisë. Banka operon në përputhje me Ligjin nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Ligjin nr.9662 datë 18 dhjetor 2006 si dhe në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Keshilli Mbikëqyres i Bankës së Shqipërisë.

Banka është një bankë tregtare, e cila ofron shërbime bankare për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Banka është regjistruar si person juridik me numër regjistrimi 33563 datë 26 maj 2005, datë në të cilën Banka filloi aktivitetin e saj tregtar. Banka mori licencën për aktivitete bankare më 9 janar 2006. Selia e Bankës është në Bulevardin Zogu I, Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i Bankës konsiston në 2,097,143 aksione me vlerë nominale 10 EUR secili dhe është detajuar si më poshtë.

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Unioni Financiar Tirane Sh.p.k (UFT)	92.25%	89.72%
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)	4.21%	6.74%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Administratori i Bankës është z.Gazmend Kadriu, i cili nuk ka pozicione drejtuese në kompani të tjera.

Drejtuesit dhe administrimi i Bankës me 31 dhjetor 2019

Drejtimi Ekzekutiv

Gazmend Kadriu	Drejtor i Përgjithshëm
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit të Biznesit
Gent Drita	Zv/Drejtor i Divizionit të Kredisë

Bordi Drejtues (Keshilli Mbikeqyres)

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anetar
Melis Ekmen Tabojer	Anetar
Gazmend Kadriu	Anetar
Sokol Marishta	Anetar
Flutura Veipi	Anetar

Komiteti i Kontrollit

Varuzhan Piranjani	Kryetar
Sonila Bicaku	Anetar
Matilda Shehu	Anetar

Z. Arten Zikaj, pervec sa me siper, eshte dhe Kryetar i Keshillit Drejtues te Landeslease dhe znj.Hasho eshte anetare e Keshillit Drejtues te Landeslease.

Banka ofron sherbimet bankare per te gjitha kompanite e grupit. Transaksionet me te shpeshta me ta jane ato te vendosjes se depozitave dhe llogarive prane saj, te kredidhenies, te garancive bankare, te procesimit te te gjitha veprimeve te lidhura me llogarite e tyre, si pritje dhe dergim i transfertave brenda dhe jashte vendit, ekzekutimin eurdher pagesave te ndyshme, arketimet dhe pagesat ne cash, e-banking etj.

Banka pergatit pasqyra financiare individuale dhe te kosoliduara me filialin e saj "Landeslease sha, ne baza vjetore. Auditimi i tyre eshte kryer nga Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar, Dega Shqiperi dhe raporti i tyre eshte ende ne proces te finalizimit te tij.

Ne date 1 nentor 2018 Banka nenshkroi marreveshjen e shitblerjes per blerjen 100% te aksioneve te Banka Nderkombetare Tregetare sha ("BNT"). Ne date 1 gusht 2019 u finalizua procesi i bashkimit te saj me Union Bank.